



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument Parlamentar*

*Tiranë, më 26.01.2022*

**RAPORT  
PËR  
PROJEKTLIGJIN  
“PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR**

**- Hyrje**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 26.01.2022.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin i Saimir Hasalla.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm:

1. Z. Besard KADIA – Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
2. Z. Elvis KOÇI – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
3. Znj. Arjana DYRMISHI – Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik;
4. Z. Flogers BROQI – Drejtor i Drejtorisë së Metodologjisë (QKB)

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

## **II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT, RISITË DHE IMPAKTI I PROJEKTLIGJIT**

### **2.1. Qëllimi i projektligjit**

Projektligji “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar ka si qëllim ndryshimin e pikave 2 e 3, të nenit 74, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, në lidhje me vlerat e gjobave që do të aplikohen në rast se gjatë deklaramit në regjistër sipas përcaktimeve të këtij ligji, subjekti tregtar do të deklarojë të dhëna të pavërteta si dhe në rast të moskryerjes së detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara nga ligji i posacëm.

Gjithashtu, në fokus të këtij projektligji është adresimi i rekomandimeve të dhëna nga “Financial Action Task Force” (FATF) në raportin e progresit për Shqipërinë në tetor 2021, konkretisht të masës 5.3, sipas së cilës: “3. *Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh treguesin e paritetit të fuqisë blerëse.*” Në konsiderim të këtij rekomandimi, grupi i pavarur i FATF-së rekomandon se vendi ynë duhet të avancojë me ndryshimet ligjore në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, në mënyrë që sanksionet administrative të jenë më bindëse.

Me anë të hartimit të amendimeve në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, synohet të rritet vlera e gjobave për deklarimin e të dhënave të pavërteta nga subjektet tregtare dhe në rast të moskryerjes së regjistrimit fillestar, dhe regjistrime të tjera të detyrueshme të subjekteve tregtare, brenda afateve të përcaktuara.

### **2.2. Risitë e projektligjit**

Ky projektligj paraqet risitë e mëposhtme:

- Konsolidon detyrimin nga ana e subjekteve tregtare për respektimin e rregullave për deklarimin e të dhënave të vërteta pranë Qendrës Kombëtare të Bizneist;
- Nxit subjektet tregtare për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.207, i ndryshuar;
- Mbron konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe përmirëson klimën e biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve;
- Ndikon në rritjen e transparencës lidhur me deklaramet dhe informacionin e dhënë nga subjektet tregtare.

## **2.3 Impakti i projektligjit**

Në ndryshim nga ligji ekzistues, aplikimi dhe përcaktimi i gjobës me vlera më të larta, do sillte efektivitet në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ndërjegjësim në qarkullimin ekonomik-tregtar në lidhje me respektimin nga ana e subjekteve tregtare të afateve ligjore të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimit fillestar dhe regjistrimeve të tjera në regjistrin tregtar dhe sigurimin e transparencës të të dhënave dhe deklarimin e të dhënave reale në regjistrin tregtar.

Nëpërmjet këtij projektakti parashikohet që në nenin 1 të bëhet ndryshimi i pikave 2 e 3, të nenit 74, të cilat ndryshohen vetëm për sa i përket vlerës së gjobës, konkretisht në pikën 2 vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta si edhe në pikën 3, vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara nga ky ligj.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË KUSHTETUESE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE AKTET NDËRKOMBËTARE**

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

### **IV. DISKUTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE**

- Për të prezantuar projektligjin në Komision ishte i pranishëm Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë Z. Kadia, i cili parashittoi se qëllimi i këtij projektakti është ndryshimi i pikave 2 e 3, të nenit 74, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, lidhur me vlerat e gjobave për deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta dhe moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara në ligj nga bizneset. Kjo nismë ka ardhur si rekomandim nga “Financial Action Task Force” (FATF), e cila në raportin e progresit për Shqipërinë rekomandon që “Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh treguesin e paritetit të fuqisë blerëse.”.

Në bazë të parashikimeve të ligjit, sipas të cilit penalteti ka qenë një gjobë prej 15.000 lekë, nga analiza e kryer vlera e saj e përlllogaritur në mënyrë proporcionale do të jetë 60 000 lekë. Kjo vjen si nëvojë për të patur trasparencë në deklarimet e dhëna pranë Regjistrin Tregtar.

- Në vlerësimin e këtij projektligji relatori deklaroi se nëpërmjet këtij akti parashikohet që në nenin 1 të bëhet ndryshimi i pikave 2 e 3, të nenit 74, të cilat ndryshohen vetëm për sa i përket

vlerës së gjobës, konkretisht në pikën 2 vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për deklarinimin në regjistrin të të dhënave të pavërteta si edhe në pikën 3, vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara nga ky ligj.

Ky ligj do të zbatohet drejtpërdrejt nga subjektet tregtare që regjistrohen në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Zonja Çupi, anëtare e komisionit ngriti pyetje për përfaqësuesit e pranishëm: - Sa është numri i rasteve të konstatuara për mosplotësim detyrimi e të gjobitura dhe sa është numri i mosregjistrimeve?

Në përgjigje të pyetjeve Z. Kadia u përgjigj se gjatë tre viteve nga 2019 të fundit rezultojnë 218 subjekte për regjistrim fillestar dhe 859 biznese për depozitim bilancin vetëm për vitin 2019 dhe afërsisht për tre vitet e fundit janë konstatuar rreth 1000-1100 subjekte/vit të cilat nuk kanë kryer regjistrimin në kohë.

Në vijim Zonja Çupi deklaroi që kjo nismë mos të jetë vetëm një impenjim për raportet kundrejt ndërkombëtarëve por adminstrata të komunikojë me bizneset dhe këto biznese të deklarohen.

- Gjithashtu, në konkluzion, Kryetarja e Komisionit sqaroi se projektligji vjen në kuadër të përmbushjes së planit të veprimit dhe masave që duhet të ndërmerri Shqipëria dhe rekomandimeve të dhëna nga “Financial Action Task Force” (FATF), në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian përse i përket marrjes së masave kundër pastrimit të parave sipas së cilës, Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh treguesin e paritetit të fuqisë blerëse.

## **VII. PËRFUNDIM**

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për ta përcjellë mendimin Komisionit përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

**RELATOR**

**SAIMIR HASALLA**

**KRYETAR**

**KLOTILDA BUSHKA**